

Nr. 2867/3 Prot

Durrës, më: 17.12.2025

V E N D I M

Nr. 146, datë 17.12.2025

PËR

"MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VITIN 2025 MBI AKTIVITETIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR GARANTIMIN E STANDARDEVE DHE CILËSISË (KPGSC), NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve dhe Cilësisë në UAMD, miratuar me Vendim Senati akademik Nr. 49, datë 06.08.2024, si dhe në shkresën me Nr. 2849 prot., datë 05.12.2025 të Kryetarit të KPGSC-së, në mbledhjen e datës 17.12.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Raportit Vjetor për vitin 2025 mbi aktivitetin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC) në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Komisioni i Përhershëm (KPGSC)
 - Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave
 - NJSBC Institucionale
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi



RAPORT VJETOR PËR VITIN 2025

MBI AKTIVITETIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR GARANTIMIN E STANDARTEVE DHE CILËSISË NË UAMD

1. Kuadri ligjor dhe institucional

Strukturat përbërëse të Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë kanë përgjegjësitë e tyre në nivel institucional për zhvillimin e cilësisë përmes përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Një ndër këto struktura në UAMD është edhe Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Standarteve dhe Cilësisë (në vijim KPGSC).

KPGSC është krijuar dhe funksionon bazuar në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46; "Statutin e UAMD-së", neni 23; "Rregulloren e UAMD-së", neni 20; "Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë" të miratuar me endimin e Senatit Akademik Nr.51. datë 19.05.2025, si dhe "Rregulloren e Funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standarteve dhe Cilësisë" të miratuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr.49. datë 6.8.2024.

KPGSC ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD, duke shërbyer si një garanci e shtuar në kuadrin e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, (6 staf akademik me kohë të plotë dhe 1 student) të miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr.51. datë 19.05.2025. Sa më sipër Komisioni aktual është mandatuar dhe ka filluar punën me këtë përbërje në 29.05.2025. Krah funksioneve të tij bazuar në legjislacionin në fuqi në vijim të punës është pasur parasysh edhe përvoja e krijuar nga komisionet e mëparshme të mandatuara nga Senati i UAMD-së, prej muajit tetor 2017, në nivel institucioni.

Misioni kryesor i komisionit është sigurimin dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në të gjitha fushat në Universitetin "Aleksandër Moisiu".

Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira në Sigurimin e Brëndshëm të Cilësisë. Në këtë kuadër pjesë thelbësore e strategjisë së punës së KPGSC-së ka qenë bashkëpunimi dhe ndërveprimi me strukturat e tjera, pjesë e UAMD, në përmbushje të detyrave dhe qëllimeve të tij për mbikëqyrjen, vlerësimin, miratimin dhe garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit. Komisioni vlerëson rëndësinë e partneritetit të ngushtë me të gjitha strukturat, pasi në këtë mënyrë puna realizohet më me efektivitet dhe krijohen mundësi me reale për përmirësimin në vijueshmëri të standarteve të cilësisë.

2. Fokusi i veprimtarisë së komisionit

Për periudhën Maj 2025 – Dhjetor 2025 puna e KPGSC është fokusuar në vlerësimin e standarteve të sigurimit të cilësisë në disa drejtime. Më konkretisht:

- KPGSC në mbledhjen e muajit Qershor u zgjodh Kryetari dhe Sekretari i komisionit
- Gjatë mbledhjes së muajit Korrik anëtarët e komisionit, ku pjesa më e madhe janë anëtarë për herë të parë në këtë komision, u njohën dhe u diskutua për "Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përherëshëm të Garantimit të Standarteve dhe Cilësisë në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", e cila është miratuar nga Senatin Akademik me vendimin nr. 46, datë 6.8.2024. Në këtë mbledhje secili anëtar u njoh me përgjegjësitë dhe detyrat që ka ky komision.
- Në mbledhjen e muajit Shtator u diskutua për dokumentacionin e aplikimit të fazës së dytë për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në "Environmental, Cultural and Tourism Economics" në gjuhën Angleze dhe gjuhën Italiane në bashkëpunim me Universitetin La Sapienza, Romë.
- Në Tetor u analizua dhe u diskutua për:
 1. Shkresën e Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave "Mbi analizën e rezultateve të pyetësorit vlerësues për cilësinë e studimeve në Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës"
 2. Shkresën e Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave "Analizë mbi analizën e rezultateve të pyetësorit vlerësues për klimën e punës në administratën e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës"
- Në mbledhjen e muajit Nëntor diskutimi ishte për relacionet e paraqitura nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë, për dokumentacionin e paraqitur nga fakultetet për hapjen e programeve të reja dhe riorganizimin e programeve ekzistuese në masën nën 20% ose mbi 20%.
- Diskutimi dhe miratimi i Raportit vjetor të KPGSC u bë në mbledhjen e muajit Dhjetor.

3. Rekomandime

Gjatë mbledhjeve të Komisionit janë diskutuar një sërë çështjesh të rëndësishme lidhur me standartet dhe cilësinë në fushën akademike, si dhe janë nxjerrë rezultate dhe bërë propozime konkrete. Disa nga këto rekomandime janë:

- Planet mësimore për programet e reja të studimit ose për ato në proces riorganizimi nevojitet që të vlerësohen më parë nga KPGSC përpara se kërkojnë miratimin nga Senati Akademik.
- Bashkëpunimi ndërmjet strukturave përbërëse të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë kërkohet të jetë i harmonizuar dhe pa pengesa. Ka raste kur informacionet e kërkuara nga KPGSC mungojnë ose nuk përcillen të plota.
- Të merren masa për të shmangur hapjen e programeve të ngjashme të studimit në njësi kryesore të ndryshme në UAMD.

Në zbatim të Kodit të Cilësisë dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, komisioni garanton se do të vijojë të ushtrojë funksionet e tij në drejtim të garantimit të standardeve të cilësisë në mënyrë të vazhdueshme, duke bashkëpunuar dhe koordinuar punën me të gjitha strukturat e universitetit me qëllim rritjen e cilësisë, si dhe konkurrueshmërisë në arsimin e lartë.

KRYETAR

Prof. Dr. Lindita MUKLI